



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE KURBIN

Nr. 5329 Prot.

Laç, me 27.06.2019

V E N D I M - S H P A L L J E

(Lidhur me ekzekutimin e "Urdherit te Ekzekutimit" te titullit ekzekutiv te debitorit)

Ne Lac, sot me date 27.09.2019
Une, Mikeda Cenaj, me detyre Permbarues Gjyqesor prane Zyres Permbarimore Kurbin, pasi studiova aktet proceduriale te ceshtjes permbarimore Nr. 80 rregj. te vitit 2019 bazuar ne Urdherin e ekzekutimit nr. -- te dates 02.05.2019 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin,

KONSTATOVA:

Se ne date 10.09.2019 eshte depozituar prane Zyres se Permbarimit kerkesa e kreditores Kristina Preng Marku se bashku me "Urdherin e Ekzekutimit" te Titullit Ekzekutiv (vendim gjyqesor) nr. 533-162 te dt 02.05.2019 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin qe ka marre forme te prere me date 10.06.2019, me pale :

- Kreditor: Kristina Preng Marku e dtj.21.07.1991 me banim ne shtepi private, Spille, Himare.
- Debitor: Agron Mark Bitraj i dtj. 04.06.1973 me banim ne Fushe-Milot.
- Me objekt: Detyrimin e Agron Bitraj te paguaje detyrim ushqimor ne shumen 15000 (pesembedhetemije) leke ne muaj per femijen Marko Bitraj .Ky detyrim ne shumen 15000 leke per femijen te llogaritet, duke filluar nga data 17.10.2018 dhe te paguhet ne favor te paditeses.

Nga ana e zyre tone permbarimore kane filluar procedurat ne baze te nenit 515 e vijues te K.Pr.Civile si dhe ligjit 8730 date 18/01/2001 "Per Organizimin dhe Funkcionimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqesor" i ndryshuar per ekzekutimin e detyrueshem te Titullit Ekzekutiv te sipercituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jone ne bashkepunim me organet kompetente rezulton se debitori Agron Mark Bitraj i dtj. 04.06.1973 nuk merr dijeni nepermjet sherbimit postar dhe si rezultat i kesaj bazuar ne nenin 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 te K.Pr.Civile duhet te behet njoftimi me shpallje publike i debitorit lidhur me detyrimin qe ai ka ndaj pales kreditore Kristina Preng Marku per pension ushqimor ne masen 15000 leke ne muaj.

Sa me siper ne mbeshtetje te Nenit 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 te Kodit Procedures Civile, ligjit Nr.8730 date 18/01/2001 "Per Organizimin dhe Funkcionimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqesor", i ndryshuar

V E N D O S A

1-Te kryej njoftimin nepermjet shpalljes publike me afat 20 (njetzet) ditor (duke mare parasysh edhe komunikimin postar) nga data 27/09/2019 - 16/10/2019 te debitorit Agron Mark Bitraj i dtj. 04.06.1973 me banim ne Fushe-Milot.

2-Ky vendim perpilohet ne disa kopje, ku nje kopje afishohet ne vendbanimin e fundit te pales debitore, nje kopje afishohet ne kendin e njoftimeve te kesaj zyre, nje kopje dergohet per afishim ne ambientet e Njesise Administrative Mamurras, nje kopje dergohet per afishim ne ambientet e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin dhe nje kopje i dergohet per publikim ne faqen zyrtare te Drejtorise se Pergjithshme te Permbarimit Tirane.

3-Kjo shpallje publike ka vleren e aktit te njoftimit per palen debitore Agron Mark Bitraj i dtj. 04.06.1973 me banim ne Fushe-Milot.

4-Pala debitore Agron Mark Bitraj i dtj. 04.06.1973 me banim ne Fushe-Milot, duhet te paraqitet prane Zyres Permbarimore Kurbin me seli ne Lgj nr.4, Lac ne katin e pare ne ambientet e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin dhe te marre kontakt me permbaruesin gjyqesor te ceshtjes permbarimore per t'u vene ne dispozicion aktet permbarimore, pasi me kalimin e ketij afati do te vijohet me ekzekutimin e detyruar sipas parashikimeve te nenit 519 e ne vijim te K.Pr.Civile.

U shpall, sot me date 27.09.2019.

PERMBARUES GJYQESOR
MIKEDA CENAJ

